



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

## GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:281335  
Datë: 23.05.2024  
Numri i dokumentit: 05724093

**CAP.nr.1625/23**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, gjyqtari individual Arsim Hamzaj, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit të përmbarimit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.a, me seli në Prishtinë, kundër debitorit të përmbarimit A.K nga fshati ,,,,, komuna e R,,,,, për shkak të përmbarimit të dokumentit përmbarimor, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - dega në Rahovec, PPP.nr.137/21, të datës 09.06.2023, me datën **13.05.2024**, mori këtë:

### A K T V E N D I M

**APROVOHET e themeltë** ankesa e debitorit të përmbarimit A.K nga fshati ,,,,, komuna e R,,,,, **PRISHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë -dega në Rahovec, PPP.nr.137/21, të datës 09.06.2023, dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në procedim të sërishëm.

### A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar, PPP.nr.137/21, të datës 09.06.2023, e ka hedhur poshtë si të pas afatshëm prapësimin e debitorit të përmbarimit, A.K nga fshati ,,,,, komuna e R,,,,, të ushtruar kundër urdhrit përmbarimor P.nr.1330/18 të datës 20.12.2018 të Përmbaruesit privat ,,,,, nga Gjakova.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori për shkak të *shkeljes esenciale të dispozitave të përmbarimit, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale*. me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, aktvendimin e atakuar ta prishë në tersi dhe lëndën ta kthejë në rivendosje, apo aktvendimi i atakuar të ndryshohet dhe të konstatohet se prapësimi është ushtruar brenda afatit

ligjor, apo debitori të lirohet nga pagesa ose gjykata të bie aktvendim për shkak të parashkrimit të borxhit.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur kreditori.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

- *Ankesa e debitorit është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori i përmbartimit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.a, me seli në Prishtinë, kanë paraqitur propozim për përmbartim, kundër debitorit të përmbartimit A.K nga fshati ,,,,, komuna e R,,,,, me urdhrin përmbartimor P.nr.330/18, të datës 20.12.2018, e ka lejuar përmbartimin, në bazë të titullit ekzekutiv - Ekstrakti nga Librat Afariste, D,-,,,,,, të datës 19.12.2018, me të cilën debitori është obliguar që kreditorit të përmbartimit t'ia kompensojnë shumën e përgjithshme prej 873.14€, të paraparë më gjerësisht si në dokumentin përmbartimor.

Kundër aktvendimit për përmbartim debitori me datë 01.12.2021 ka paraqitur prapësim. Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar PPP.Nr.137/2021 të datës 09.06.2023, e ka hedhur poshtë si të pasafatshëm prapësimin e debitorit dhe e ka lënë në fuqi urdhrin me të cilin është lejuar përmbartimi.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se prapësimi i debitorit të përmbartimit, A.K i ushtruar kundër urdhrin të përmbartuesit privat P.nr.1330/18 i datës 20.12.2018, është i pasafatshëm sepse kemi mosrespektim të afatit lidhur me të drejtën e paraqitjes së prapësimin kundër aktvendimit, përkatësisht urdhrin për përmbartim, respektivisht prapësimi është paraqitur pas afatit ligjor, sipas nenit 69 par. 1,2 dhe 3 të LPP-së dhe nenin 70 të LPP-së. Pra, sipas këtyre dispozitave ligjore, rrjedh se prapësimi është i pasafatshëm, sepse pas pranimit të shkresave të lëndës P.nr.1330/18 të përmbartuesit privat më datë 23.11.2021, e deri në datën e paraqitjes së prapësimin nga debitori i përmbartimit më datë 01.12.2021, kanë kaluar 8 ditë dhe rrjedhimisht gjykata në përputhje me nenin 73 par. 3 ka vendosur që prapësimin e palës debitore ta hedhë si të paafatshëm, për arsyet dhe shkaqet e përmendura.

Gjykata e Apelit duke u bazuar nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, për shkak se aktvendimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 të LPK-së, lidhur me nenin 70 të LPP-së.

Gjykata e shkallës së parë gabimisht ka bërë konstatimin e faktit se debitori nuk e ka parashtruar brenda afatit ligjor prapësimin. Nga shkresat e lëndës, gjegjësisht shkresa e lëshuar

nga Posta e Kosovës, vërtetohet se debitori prapësimin e ka dorëzuar në postë me datën 27.11.2021, që do të thotë brenda afatit të paraparë për parashtrimin e prapësimin, (që do të thotë brenda afatit ligjor - në ditën e 4-të), mirëpo se si ka ardhur gjykata deri te një konstatim i tillë se nuk është dorëzuar jashtë afatit nuk dihet, me ç'rast me aktvendimin e ankimuar e ka hedhur si të paafatshëm prapësimin e debitorit. Edhe nëse eventualisht mund të bëhet fjalë për ndonjë ngatërresë në përcjelljen e këtij prapësimi në shkresat e lëndës, megjithatë një gjë e tillë nuk bie nën përgjegjësinë e palës debitore, e cila nuk e ka bërë ndonjë lëshim në dorëzimin e prapësimin brenda afatit ligjor, andaj nuk mund t'i bartë edhe pasojat për një situatë të tillë. Çfarëdo lëshimi eventual nga ana e gjykatës së shkallës së parë, përkatësisht administratës së gjykatës lidhur me komunikimin e shkresës për dorëzimin e prapësimin që ka ndikuar në konstatimet e gabuara lidhur me dorëzimin e prapësimin nga ana e debitorit, e si rezultat i kësaj, nuk ka pasur hapësirë për aplikimin e dispozitave nga neni 70 i LPP-së, kur është hedhur poshtë prapësimi i debitorit.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit gjeti se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të lartcekura, të cilat duhet të eliminohen në riprocedurë, në atë mënyrë që meqë prapësimi i palës debitorë është dorëzuar brenda afateve ligjore sipas udhëzimeve të dhëna dhe brenda afatit të dhënë, të vazhdojë procedurën në mënyrë të rregullt, ashtu që të vendosë meritorisht për prapësimin, pasi që i njëjti është dorëzuar brenda afatit ligjor si dhe të ndër marrë veprime tjera procedurale me qëllim të shqyrtimit efikas të kësaj çështjeje juridike, rrjedhimisht krijimit të kushteve për nxjerrjen e një vendimi të drejtë dhe të ligjshëm. Në çdo rast veprimet dhe vendimet e gjykatës duhet të jenë në harmoni me dispozitat ligjore dhe standardet e gjykimit të drejtë.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se *"Në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual"*.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208, 209 pika d) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**CAP.nr.1625/23, datë 13.05.2024**

**Gjyqtari**  
**Arsim Hamzaj**